

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

I. OBJEKTI I PROKURIMIT: “Punime civile, rrethim, hidroizolim ndërtesat e N/Stacioneve DTL”, marrëveshje kuadër me një operator ekonomik, me afat 24 muaj.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

- **Punë shkatërruese për ndërtim dhe punë prishëse dhe punë gjërmuese:** 45110000-1;
- **Punime gjërmimi:** 45112500-0;
- **Punime ndërtimi:** 45210000-2;
- **Punime betoni:** 45262300-4;
- **Punime hidroizolimi:** 45261420-4;
- **Shërbime për përpunim të hekurit:** 71550000-8;
- **Punime muratimi:** 45262522-6;
- **Suvatim:** 45410000-4;
- **Lyerje:** 45442100-8;
- **Shtylla kabllorsh elektrike:** 31682410-7;
- **Pajisje të nënstacionit:** 31682540-7;
- **Instalime elektrike:** 45310000-3;
- **Pajisje elektrike emergjente:** 31682500-5;
- **Pajisje ndriçimi dhe llamba elektrike:** 31500000-1;
- **Instalime hidraulike:** 43328000-8;
- **Instalime boilerësh:** 42160000-8;
- **Lavamanë:** 44411300-7;
- **Instalime të dyerve dhe dritareve dhe komponentëve të ngjashëm:** 45421100-5;
- **Instalacione të strukturave metalike:** 45223110-0;
- **Instalacione për trotuare:** 45213316-1;
- **Shërbime të çpyllëzimit:** 77211400-6;
- **Rrjeta teli:** 44313100-8;
- **Instalime kondicionerësh:** 45331220-4.

VLERA E FONDIT LIMIT: 85,000,000 (Tetëdhjetë e pesë milionë) lekë pa TVSH, vënë në dispozicion nga të ardhurat OSSH SH.A për vitin 2025 - 2026 për objektin: **“Punime civile, rrethim, hidroizolim ndërtesat e N/Stacioneve DTL”**.

Shumatorja e çmimeve për njësi është: **2,618,238.72** (dy milionë e gjashtëqind e tetëmbëdhjetë mijë e dyqind e tridhjetë e tetë pikë shtatëdhjetë e dy) Lekë pa TVSH.

Kriteri për vlerësimin e ofertave në këtë procedurë është “shumatoria e çmimve për njësi” e deklaruar më sipër dhe klasifikimi përfundimtar i operatorëve ekonomikë do të bëhet sipas këtij kriteri.

- Ofertuesit duhet të paraqesin ofertën e tyre ekonomike referuar zërave të preventivit sipas **Ankesit A “Preventivi i zerave njesi per punime civile”** i cili pjesë e pandarë e dokumenteve të tenderit.
- Vlera e pritshme e kontratave është 85,000,000 lekë pa TVSH dhe sasi të paraqitura në **Aneksin B “Preventivi i zerave dhe volumet e parashikuara te punimeve civile”**, janë vetëm sasi orientuese dhe nuk e kushtëzojnë Autoritetin Kontraktor për t’i blerë ato.

Përzgjedhja e marrëveshjes kuadër si mjet prokurimi është vlerësuar si mënyra më e përshtatshme për zgjidhjen e problematikave të mirëmbajtjes së N. Stacioneve elektrike të shpërndarjes, pasi nëpërmjet saj, kjo mirëmbajtje mund të realizohet në mënyrën më efektive. Ky mjet prokurimi siguron përmbushjen e qëllimit të kontratës duke ruajtur vijimësinë e realizimit të punimeve civile sipas nevojave të autoritetit kontraktor dhe fondeve në dispozicion.

Në marrëveshjen kuadër që do të nënshkruhet me operatorin ekonomik të suksesshëm pas përfundimit të procedurës, do të përcaktohen kushtet e kontratës që kanë të bëjnë me çmimin e zërave të punimeve të përcaktuar në preventiv dhe sasi të parashikuara të punimeve të mirëmbajtjes, për një afat prej dy vitesh nga lidhja e marrëveshjes kuadër.

Konkretisht përzgjedhja e marrëveshjes kuadër është bërë referuar:

- nenit 52/3 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar;
- nenit 64 të VKM-së nr. 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar,

ku përcaktohet se “Kontratat e bazuara në marrëveshjet kuadër të lidhura me një operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, duhet të akordohen brenda kufijve dhe kushteve të parashikuara në marrëveshjen kuadër. Në kontratat e bazuara në marrëveshjen kuadër nuk mund të bëhen ndryshime të kushteve, për të cilat është lidhur marrëveshja, pasi kjo do të konsiderohej shkelje e marrëveshjes kuadër”.

Nevojat objekt kontrate përfshijnë punime të ndryshme për riparimin apo mirëmbajtjen e N. Stacioneve elektrike të shpërndarjes të cilat konkretizohen kryesisht në punimet e përcaktuara më sipër.

Këto punime janë të lidhura teknikisht dhe ngushtësisht me njëra tjetrën dhe realizimi i tyre nga operatorë të ndryshëm jo vetëm që nuk do të jetë i favorshëm dhe do të shkaktojë vështirësi

autoritetit kontraktor, por do të sjellë edhe vështirësi në respektimin e kushteve të garancisë për punimet e kryera nga operatorë të ndryshëm në të njëjtin objekt (N/stacion).

Në rastin kur në marrëveshjen kuadër do të përcaktohen kushtet e kontratës që kanë të bëjnë me çmimin e zërave të punimeve të përcaktuar në preventiv (çmim për njësi) dhe sasi të parashikuara të punimeve të mirëmbajtjes, për një afat prej dy vitesh, autoriteti kontraktor ka vlerësuar si formën më efektive marrëveshjen kuadër me një Operator Ekonomik.

Krahas sa më sipër autoriteti kontraktor vlerëson dhe argumenton se marrëveshja kuadër me një operator ekonomik ka edhe avantazhet lidhur me unifikimin e përgjegjësisë dhe të cilësisë së punimeve, pasi në rastin e MK me një OE nuk ka problematika që mund kenë nevojë për koordinim apo mospërputhje të standardeve teknike gjatë zbatimit të punimeve dhe përgjegjësia është qartësisht e evidentuar dhe e lidhur me sipërmarrësin e punimeve. Gjithashtu një marrëveshje kuadër me një operator ekonomik siguron shpejtësi dhe fleksibiliteti në plotësimin e nevojave të Autoritetit Kontraktor.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Drejtoria e Tensionit të Lartë OSSH SH.A ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë :

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3.

Argumentimi (1. a & b)

Kërkesa për Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit bazohet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 76 dhe 82 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni II, Neni 26.

Kërkesa për sigurimin e ofertës mbështetet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 83, pika 1 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni II, Neni 30, pika 1.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë :

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale :

Sipas kriterëve të përgjithshme të pranimit/kualifikimit (shtojca 7).

Argumentimi (2.1)

Kërkesa e mësipërme bazohet në Nenin 77, pika 1/a dhe pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar); si dhe Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar).

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet ekonomike dhe financiare, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022, 2023 dhe 2024, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e fondit limit / vlerës së pritshme të kontratës.

Argumentimi (2.2.1)

Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në Kreun V, Seksioni III, Nenin 43, pika 2 dhe pika 3 e VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Kërkesat e renditura sipas Kapacitetit ekonomik dhe financiar i shërbejnë Autoritetit Kontraktor, për të provuar nëse Ofertuesit zotërojnë kapacitet financiar për të përmbushur me sukses kontratën objekt prokurimi.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë :

Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

- vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar, bazuar në shkronjën “b”, të pikës 2, të nenit 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës = 85,000,000.00 (tetëdhjetë e pesë milionë) Lekë pa TVSH.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 1, të nenit 43 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Gjithashtu kjo kërkesë për kualifikim bazohet edhe në nenin 43, pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, cituar:

5. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale, llogaritet mbi bazën e vlerës maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

2.2.2 Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (tri) viteve të fundit financiare (2022, 2023 dhe 2024) të paraqitur në Autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky Autoritet si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar. (Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse bilancet janë në përputhje me parashikimet e nenit 43/4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, të ndryshuar).

Shënim: Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

Argumentimi (2.2.2)

Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; si dhe Kreu V, Seksioni III, Nenit 43, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligjit Nr. 10091 date 5.3.2009 “Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar” (i ndryshuar).

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke i'u referuar legjislacionit të prokurimit publik dhe atij të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar nenit 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.2.3 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2025, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas ligjit nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar; (lidhur me afatet e kryerjes së pagesave të caktuara nga njesite e veteqeverisjes vendore për vitin 2025), në të cilën është regjistruar sipas QKB dhe vendimeve të Këshilleve Bashkiake të njësive vendore ku operatorët ushtrojnë aktivitetin.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit të BOE duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga njësite e veteqeverisjes vendore ku ka ushtruar apo ushtron aktivitet për periudhën e kërkuar, sipas QKB.

(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit përmbledhës të vetedeklarimit dhe dokumentet përkatëse vërtetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, sipas parashikimeve në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik).

Argumentimi (2.2.3)

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar me qëllim që operatorët ekonomikë të vërtetojnë se shlyejnë detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në çdo adresë ku ushtrojnë aktivitetet. Kjo kërkesë është përcaktuar sipas Nenit 76 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; Kreut V, Seksioni III, Nenin 43, pika 6 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe sipas Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar), cituar Neni 5, gërma “c” si vijon:

“...përcakton numrin e kësteve të pagimit të taksës dhe afatet e kryerjes së tyre, si dhe kushtet lehtësuese në rastet e pagesës së plotë dhe përpara afateve të detyrimeve fiskale”.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:

2.3.1 Operatorët ekonomikë duhet të kenë përvojë të suksesshme në kontrata të mëparshme dhe për këtë duhet të paraqesin :

- a)** dokumentacion për punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të ulët se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;
- b)** dokumentacion për punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e ulët se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

Për kontrata të realizuara me ente publike operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:
- Kontratë Sipërmarrje;
- Situacionin përfundimtar;
- Fatura tatimore të situacionit përfundimtar të deklaruara në organet tatimore;
- Aktin e kolaudimit;
- Certifikaten e marrjes në dorezim të perkohshëm/përfundimtar.

Shënim : *Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.*

Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm :

- Vertetim leshuar nga subjekti privat, shoqëruar me:
 - Kontrate Sipërmarrje;
 - Situacionin përfundimtar;
 - Fatura tatimore të situacionit përfundimtar të deklaruara në organet tatimore;
 - Akt kolaudimi objekti.
- Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues, krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast respektivisht, duhet të paraqesë edhe Kontraten e bashkimit të operatoreve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet që ka marrë përsiper të kryejë secili anëtar i BOE.
- Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën baze ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor, si dhe miratimin zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

Argumentimi (2.3.1)

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe në nenin 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet ose punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës së

fondit limit të kontratës që prokurohet për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë :

$85,000,000 \times 50\% = 42,500,000 \text{ Lekë}$

$85,000,000 \times 2 = 170,000,000 \text{ Lekë}$

Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues, është kërkuar edhe paraqitja e kontratës së bashkimit të operatoreve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet që ka marrë përsiper të kryejë secili anëtar i BOE, mbështetur në parashikimet e nenit 88 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij dokumentacioni AK ka mundësi të njihet me vlerën reale të punimeve të realizuara nga ofertuesi/t, mbi bazën e një kontrate të realizuar si BOE.

Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor është kërkuar edhe miratimi nga ana e autoritetit kontraktor, si nënkontraktor i deklaruar, në respektim të parashikimeve të nenit 89 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Pra, dokumentacioni i kërkuar si më sipër, është kërkuar me qëllim që AK të përlogarisë vlerën e saktë të kontratave të mëparshme të realizuara nga ofertuesi, brenda afatit të përcaktuar në pikën 2.3.1, shkronja a) dhe b).

2.3.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastruktura dhe Energji, në bazë të VKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme :

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit :

- **N.P - 1 A** Punime gjurmimi në tokë;
- **N.P - 3 A** Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasadash;
- **N.P - 11 A** Ndërtime për nënstacione, kabinat e transformacionit linjat e T/N dhe tensionit të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë elektrike.

Për punimet speciale të ndërtimit :

- **N.S - 1 A** Punime për prishjen e ndërtimeve;
- **N.S - 2 A** Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre;
- **N.S - 4 A** Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me material druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtues;
- **N.S - 8 A** Ndërtime parafabrikat me beton të armuar, struktura metalike dhe druri;

- **N.S - 14 A** Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV.

Për operatorët e huaj të bëhet njehsimi i liçencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Institucionit përkatës, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.

Argumentimi (2.3.2)

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe në nenin 39, pika 6/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, si dhe VKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” (lidhja 2, 3 dhe 4).

Konkretisht :

Kategoritë e licencave janë përcaktuar bazuar në zërat e punimeve që parashikohet të realizohen në funksion të përmbushjes së qëllimit të kontratës, ndërsa klasifikimi i tyre, sipas niveleve (gërmave) përkatëse është përcaktuar në klasifikimin bazë (A) pasi volumet e punës që do të realizohen janë vetëm sasi / punime të planifikuara.

- **N.P - 1 A “Punime gërmimi në tokë”**

Sipas VKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, kategoria **N.P - 1 A “Punime gërmimi në tokë”** konsiderohen gërmimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjeti, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gërmohet ose sistemohet vegjetale, argjilore, ranore, zhavorrishte ose shkëmbore.

Kjo kategori licence i referohet punimeve të parashikuara në zërat e preventivit për realizimin e punimeve për trotuare, muret rrethues, portat e nënstacioneve, konkretisht për punimet si vijon:

- **N.P - 1 A “Punime gërmimi në tokë”**
 - **Zerat dhe volumet sipas preventivit.**

Punime gërmimi		
Gërmime dheu në seksion të lirë me krahe, në tokë të butë, kateg.I-II, transport karro dore deri 10 m	m ³	65.00
Mbushje, rrafshim, ngjeshje me tokmak elektrik, cdo 30 cm, tokë të butë	m ³	55.00

Germim e mbushje dheu me krah kat III per themele, h=1.5m	m ³	45.00
---	----------------	-------

- **N.P - 3 A “Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasadash”.**

Sipas VKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, kategoria **N.P - 3 A “Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasadash”** konsiderohen zgjidhjet dhe koordinimi i punimeve të specialiteteve të nevojshme për riaftësim, konservim, konsolidim, transformim, rivlerësim, ristrukturim. Konsiderohen gjithashtu dhe finitura të llojeve të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje.

Kjo kategori licence i referohet punimeve të parashikuara në zërat e preventivit për realizimin e punimeve të ndryshme për rikonstruksionin e nënstacioneve, konkretisht për punimet si vijon:

- **N.P - 3 A “Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasadash”.**

➤ **Zerat dhe volumet sipas preventivit.**

Punime Shtresa, Veshje, Suvatime, Lyerje,Tretuare, Hidroizolimi		
Shtrese lluster cemento 1:2	m ²	2250.00
Nenshtrese zhavori	m ³	45.00
Gjeotekstil me gramature 280 g/m2	m ²	4500.00
F.V. zall mbi zgaren metalike	m ³	55.00
Shtrese me pllaka grez porcelanato	m ²	750.00
Veshje me pllake majolike	m ²	155.00
Suva brenda mur tulle ~ 4m, me krah, llaç perzier M 25	m ²	5500.00
Suva solete ~ 4 m me drejtues, me krah	m ²	2250.00
Suva trare e kollona ~ 4m, me krah, llaç perzier M 25	m ²	150.00
Suva e zakonshme fasade mur tulle ~ 8m	m ²	3250.00
Trotuar me lluster çimento, pa borduren e betonit	m ²	255.00
Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 2 k katrama	m ²	2500.00
Shtrese lluster cemento 1:2 t = 20 mm	m ²	2500.00
Ulluk shkarkimi horizontal me llamarine xingat 33cm	ml	550.00

Ulluk shkarkimi vertikal me llamarine xingat Ø 100	ml	200.00
Bojatisje me gelqere	m ²	12500.00
Boje hidroplastike cilesi e larte	m ²	6500.00
Boje vaji ne siperfaqe metalike	m ²	650.00

- **N.P - 11 A “Ndërtime për nënstacione, kabinat e transformacionit linjat e T/N dhe tensionit të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë elektrike”.**

Sipas VKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, kategoria **N.P - 11 A** “Ndërtime për nënstacione, kabinat e transformacionit linjat e T/N dhe tensionit të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë elektrike” konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje në rrjet që janë të nevojshëm për shpërndarjen e T/N dhe tensionit të mesëm dhe për transformimin dhe shpërndarjen e tensionit të ulët deri te përdoruesit e energjisë elektrike, të kompletuar me punimet e muraturës, plotësuese ose ndihmëse, të veçanta ose të rrjetit.

Përfshin në mënyrë të thjeshtuar centrale dhe kabina transformacioni, shtyllat metalike të nevojshme për transportin dhe shpërndarjen e çfarëdo lloji tensioni, furnizimin dhe vendosjen në vepër të linjave elektrike për çfarëdo numër fazash elektrike, ajrore ose tokësore.

Kjo kategori licence i referohet punimeve të parashikuara në zërat e preventivit për realizimin e punimeve të ndryshme elektrike në ndërtesa dhe nënstacione, konkretisht për grup punimet si vijon:

- **N.S – 1 A “Punime për prishjen e ndërtimeve”.**

Sipas VKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, kategoria **N.S - 1 A** “Punime për prishjen e ndërtimeve”, konsiderohet çmontimi i impianteve industriale dhe prishja komplet e ndërtesave me pajisje speciale ose me përdorim eksplozivi me prerje të strukturave betonarme dhe prishjeve në përgjithësi përfshi edhe grumbullimin e mbeturinave, ndarjen e tyre dhe riciklimin e materialeve

Kjo kategori licence i referohet punimeve të parashikuara në zërat e preventivit për realizimin e punimeve të ndryshme ndërtimore që paraprihen nga punimet e prishjes, konkretisht për punimet si vijon:

- **N.S – 1 A “Punime për prishjen e ndërtimeve”.**
 - **Zerat dhe volumet sipas preventivit.**

Punime Prishjeje

Prishje shtresa betoni	m ³	55.00
Prishje soleta b/a	m ³	125.00
Prishje kollona, trare b/a	m ³	6.20
Prishje mure beton b/a	m ³	8.50
Prishje mure betoni	m ³	15.00
Prishje struktura prej guri	m ³	17.00
Prishje struktura prej betoni	m ³	35.00
Prishje mur tulle pa pastrim	m ³	60.00
Prishje mur blloqe betoni	m ³	11.00
Prishje suvatim muri brenda	m ²	4250.00
Prishje suvatim solete (h<4m)	m ²	2500.00
Prishje suvatim kolona/trare (h<4m)	m ²	220.00
Prishje suvatim i jashtem	m ²	4500.00
Heqje dyer ekzistuese	m ²	257.00
Heqje dritare ekzistuese	m ²	100.00
Heqje pllake dyshemeje	m ²	300.00
Heqje pllakash majolike	m ²	84.00
Heqje plintuesa	ml	400.00
Prishja e davancaleve ekzistuese (dritareve) + korimano shkallesh	m ²	80.00
Prishje e hidroizolimit ekzistues (tarrace)	m ²	1200.00
Prishje trotuari ekzistues	m ²	120.00
Prishje rrethim me kolona b/a + rrjete teli	m ²	950.00

- **N.S - 2 A “Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre”.**

Sipas VKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, kategoria **N.S - 2 A** “Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre” konsiderohet, montimi, mirëmbajtje ose ristrukturim i impianteve hidrosanitare të kuzhinës, lavanterisë së gazit dhe kundër zjarrit, sado që të jetë shkalla e rëndësisë së veprave, e kompletuar me punimet e muraturës plotësuese ose ndihmëse, që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithëshme.

Kjo kategori licence i referohet punimeve të parashikuara në zërat e preventivit për realizimin e punimeve të ndryshme ndërtimore, konkretisht për punimet si vijon:

- **N.S - 2 A “Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre”.**
 - **Zerat dhe volumet sipas preventivit.**

Punime hidraulike dhe hidrosanitare		
F.V. WC allaturka	cope	22
F.V. Lavaman porcelani	cope	22
F.V. Pisuar porcelani	cope	22
F.V. Bolier 80 liter, uje te ngrohte	cope	22
F.V. Rezervuari zingato 1000 litra	cope	22
F.V. Tuba e rakorderi ujesjellesi PPR d=20~25mm, Pn 25	ml	1450
F.V. Tuba plastmasi dhe rakorderi	ton	0.24
F.V. Tuba e rakorderi PVC	kg	550
F.V. Saracineska bronzi Ø 1/2 " = 15 mm	cope	22
F.V. Tub kanalizimi ø 170	ml	160
F.V. Tub kanalizimi ø 200	ml	95
Pusete shkarkimi 80x80,h=100 cm	cope	5

N.S - 4 A Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me material druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtues.

Sipas VKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, kategoria **N.S - 4 A** “Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastike, metalike dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese” konsiderohet ndërtimi, mirëmbajtje ose ristrukturim i muraturës dhe mureve ndarës të çfarëdo lloji, tipi, përfshirë suvatimin, patinimin, bojatisjen dhe punime të ngjashme me to.

Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i karpenterisë dhe punimeve prej druri, të dyerve dhe dritareve të brendshme dhe të jashtme, të veshjeve të brendshme dhe të jashtme të dysHEMEVE të tipeve të ndryshme dhe me materiale të ndryshme dhe të punimeve të realizuara me dorë, me metal, dru, material plastik dhe material xhami ose të ngjashëm.

Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i izolimit termik dhe akustik, nënçatitë dhe mbrojtja nga zjarri, izolimi i natyrave të ndryshme dhe me materiale të ndryshme.

Kjo kategori licence i referohet punimeve të parashikuara në zërat e preventivit për realizimin e punimeve të ndryshme ndërtimore, konkretisht për grup punimet si vijon:

N.S - 4 A Punime rifiniture të muraturës

➤ **Zerat dhe volumet sipas preventivit.**

Punime dyer dhe dritare rifiniture		
F V dritare d/alumini tek xham	m ²	80.00
F V dyer d/alumini plastike me dopio xham	m ²	120.00
F V dritare d/alumini plastike me dopio xham	m ²	257.00
Shtrese me pllaka mermeri, 40x40cm	m ²	80.00
Suva brenda mur tulle ~ 4m, me krah, llaç perzier M 25	m ²	5500.00
Bojatisje me gelqere	m ²	12500.00
Boje hidroplastike cilesi e larte	m ²	6500.00

- **N.S - 8 A Ndërtime parafabrikat me beton të armuar, struktura metalike dhe druri.**

Sipas VKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, kategoria **N.S - 8 A** “Ndërtime parafabrikat me beton të armuar, struktura metalike dhe druri” përfshin prodhimin në rrugë industriale dhe montimin në vepër të strukturave parafabrikate prej betoni të armuar, normal dhe të paranderur. Prodhimin në kantier dhe montimin në vepër të strukturave prej çeliku ose të fasadave të përbëra nga telajo metalike dhe elemente modulare prej xhami ose materiali tjetër. Prodhimin në rrugë industriale dhe montimin në vend të strukturave të përbëra nga elementë të drejtë të trajtuar përpara.

Kjo kategori licence i referohet punimeve të parashikuara në zërat e preventivit për realizimin e punimeve të ndryshme ndërtimore, konkretisht për punimet si vijon:

N.S - 8 A Ndërtime parafabrikat me beton të armuar

➤ **Zerat dhe volumet sipas preventivit.**

Punime betoni parafabrikat		
Shtrese betoni C 12/15	m ³	25.00

Shtrese betoni C 16/20	m ³	39.00
Trare e arkitrare b/a C20/25 h ~ 4m	m ³	28.00
Soleta te plotat b/a C 20/25 t = 10 cm, h ~ 4m	m ³	30.00
Soleta b/a me polisterol dhe rrjete teli C 20/25 t = 30 cm, h ~ 6m	m ²	150.00
Struktura monolite betoni me çakell C 25/30 per bazamentin	m ³	55.00
Themel e xokol betoni C 12/15	m ³	42.00
Mure b/a t = 11-20cm h ~ 4m C 16/20	m ³	35.00
Kollona b/a monolite C 20/25 h ~ 4m	m ³	25.00
Plinta e bazamente b/a monolite deri 20m ³ C 16/20	m ³	65.00
Plinta b/a C20/25	m ³	25.00
Brez b/a C20/25	m ³	45.00
Themel betoni C16/20	m ³	35.00

• **N.S - 14 A Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV.**

Sipas VKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, kategoria **N.S - 14 A** “Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV”: *Konsiderohet montimi, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i linjave elektrike, telefonike, radiotelefoni e TV, si edhe të linjave të trasmetimit të ngjashme me to, të kompletuar me çdo punim të lidhur me muraturën, plotësuese ose ndihmëse, për t’u realizuar, të ndara nga zbatimi i sistemeve të tjera që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme.*

Kjo kategori licence i referohet punimeve të parashikuara në zërat e preventivit për realizimin e punimeve të ndryshme, konkretisht për punimet si vijon:

N.S - 14 A Impiante të brendshme elektrike,

➤ **Zerat dhe volumet sipas preventivit.**

Impiante të brendshme elektrike, telefonie		
F.V kuti shperndarese jashte murit	cope	100
F.V kuti jashte murit 3 mod	cope	50
F.V kuti jashte murit 4 mod	cope	50

F.V priza shuko universal	cope	50
F.V Prize sherbimi 16A UPS e kuqe	cope	50
F.V Prize interneti	cope	20
F.V Kabell Interneti Cat 5e SFTP (4 x 2 x 0.6 mm2)	ml	200.00

2.3.3 Dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik:

a) Operatorët ekonomikë pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojnë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, si më poshtë :

- Inxhinier Ndërtimi 1 (një)
- Inxhinier Hidroteknik 1 (një)
- Inxhinier Elektrik 1 (një)

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin :

- Kontratë pune, Diplomën Universitare, Libreze pune dhe Cv.

Drejtuesit teknik duhet të jenë të punësuar sipas kriterëve të VKM nr. 42 date 16.01.2008, i ndryshuar, sa i takon ndalimeve të dypunësimit.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të bëjë verifikime lidhur me deklarinimin e OE, në funksion të përmbushjes së këtij kriteri.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

b) Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë staf teknik dhe punonjës të specializuar/kualifikuar, si më poshtë :

- Arkitekt 1 (një)
- Teknik Ndërtimi 4 (kater)
- Teknik Hidraulik 2 (dy)
- Teknik Elektrik 2 (dy)
- Hidraulikë 4 (katër)
- Elektricitë 4 (katër)
- Përgatitës të konstruksioneve metalike dhe të ngjashëm 6 (gjashtë)
- Saldator dhe prerës të metaleve 4 (kater)
- Hidroizolues 15 (pesëmbëdhjetë)
- Muratorë 6 (gjashtë)

- Bojaxhi 6 (gjashtë)
- Shtrues pllakash dhe të tjerë që lidhen me to 6 (gjashtë)

Për punonjësit me profesionet si më sipër, operatorët ekonomikë duhet të plotësojnë dhe të paraqesin tabelën me të dhënat si më poshtë :

Nr.	Emër Mbiemër i punonjësit	Profesioni	Institucioni publik/privat lëshues i certifikatës/diplomës	Nr NIPT (Në rast se lëshuesi është institucion privat)
1				
2				
etj				

Për punonjësit e kualifikuar si më sipër, ofertuesi duhet të paraqesë :

A) Për arkitektin:

- Kontratë pune, Diplomën Universitare, Libreze pune dhe CV.

B) Për teknikët:

- Kontratën individuale të punës dhe
- diplomën e shkollës së mesme profesionale përkatëse ose diploma bachelor në fushën përkatëse.

C) Për punonjësit e tjerë:

- kontratën individuale të punës;
- një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/certifikatë/diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.”.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

- c) Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se kanë të punësuar në stafin e tyre 1 (një) punonjës i cili të plotësojë kërkesat dhe të disponojë certifikatën si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit

në punë”, në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10237 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M Nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier". Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin :

- kontratën e punës,
- diplomën/certifikatën përkatëse.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

d) Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të dëshmojnë se kanë të punësuar në stafin e shoqërisë punonjës të kualifikuar, të pajisur me Dëshmi të Aftësive Profesionale (DAP), lëshuar nga D.P.SH.T.RR., minimalisht si më poshtë :

- Automakinist 2 (dy)

(Në rastet kur mjetet/makineritë dispononohen me qera, këta punonjës mund të jenë të kontraktuar).

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin :

- Kontratat e punës të vlefshme;
- Dokument (dëshmi kualifikimi profesional), që të vërtetojë kualifikimin profesional të kërkuar, referuar rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtim dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre”, miratuar me urdhërin nr. 200, datë 16.5.2019, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjitikës.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

e) Nga punonjësit e kërkuar më sipër, minimalisht punonjësit e kualifikuar si:

- Ing Elektrik 1 (një)
- Teknik Ndërtimi 2 (dy)
- Teknik Elektrik 2 (dy)
- Elektricistë 4 (katër)

duhet të jenë të pajisur me OMVK në përputhje me kërkesat ose standardet ekuivalente sipas Rregullores së sigurimit dhe shfrytëzimit teknik për impiantet, pajisjet dhe instalimet elektrike.

Për këtë operatorët ekonomikë krahas dokumentacionit të kërkuar në pikën 2.3.3 /b, duhet të paraqesin edhe dëshminë përkatëse që vërteton kualifikimin OMVK.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

f) Të gjithë punonjësit e kërkuar sipas pikës 2.3.3, duhet të jenë në listpagesat e shoqërisë, për periudhën Gusht - Tetor 2025. Përfshirë nga kjo bëjnë punonjësit e kualifikuar si (Automakinist), të kërkuar sipas gjurmës “d”, të cilët përveç se si pjesë të stafit të ofertuesit (në listpagesat e tij) mund të jenë të kontraktuar vetëm në rastet kur mjetet/makineritë disponohen me qera.

Ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, duhet të dorëzojë pranë autoritetit kontraktor përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK, dokumentacionin si më poshtë :

- Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën Gusht - Tetor 2025.

Argumentimi (2.3.3. a dhe b)

Kërkesat e shkronjave a) dhe b), të pikës 2.3.3, të kriterëve të veçanta për kualifikim, janë bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, në nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.” dhe VKM nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”, të rishikuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe nevojave për realizimin e punimeve.

Konkretisht N.Stacionet janë të ndara në 4 rajone me një numër total prej 185 nga te cilet me emergjentet per nderhyrje jane renditur me poshte.

Nr.	NJ.T.L. QENDER	Nr.	NJ.TL. VERI
1	N.ST Uz.Dinamo	50	N.ST Laç-1
2	N.ST Pall.Kongreseve	51	N.STLaç-2

3	N.ST Selite	52	N.ST Fush-Kuge
4	N.ST Mezez	53	N.ST Mamurras
5	N.ST Shkozet	54	N.ST Rreshen
6	N.ST Kavaje	55	N.ST Rubik
7	N.ST FusheKruje	56	N.ST Repsi
8	N.ST Kruje	57	N.ST Kaçinar
NJ.TL. JUG LINDJE		58	N.ST Kurbnesh
9	Nst. Nr.1 Elbasan 35/10 kV	59	N.ST Lezhe
10	Nst. Nr.3 Elbasan 110/6/10 kV	60	N.ST Rrile
11	Nst. Nr.4 Elbasan 35/10 kV	61	N.ST Shkodra-1
12	Nst. Nr.5 Elbasan35/6 kV	62	N.ST Shkodra-2
13	Nst. Vranisht 35/10 kV	63	N.ST Bushat
14	Nst. Kajan 110/10 kV	64	N.ST Vau-Dejes
15	Nst. Kombinat Berat 35/6 kV	65	N.ST Rrenx
16	Nst. Uznove e Vjeter 110/35/6 kV	66	N.ST Shkodra-3
17	Nst. Pobrat 35/10 kV	67	N.ST Dobraq
18	Nst. Mollas 35/10 kV	68	N.ST Koplik
NJ.TL. JUG PERENDIM		69	N.ST Bajze
19	N/st Fieri 1 _35/6kV	70	N.ST Vukpalaj
20	N/st Jagodine _110/35/6 kV	71	N.ST Vrake
21	N/ST Matke _35/10kV	72	N.ST Dajç
22	N/ST Kafaraj _110/35/6 kV	73	N.ST Ças-Velipoje
23	N/ST Patos _35/6 kV	74	N.ST Velipoje
24	N/ST Drenove _110/6 kV	75	N.ST Zues
25	N/ST Libofsh _35/10kV	76	N.ST Trush-2
26	N/ST Cakran _35/10/6 kV	77	N.ST Koman
27	N/ST Povelc _35/6/04 kV	78	N.ST Bushat i Ri
28	N/ST Lushnje _35/6 kV	79	N.ST Bulqize
29	N/ST Mertish _35/10 kV	80	N.ST Shupenze
30	N/ST Ardenice _35/10 kV	81	N.ST Kraste
31	N/ST Uji I Ftohte _35/6 kV	82	N.ST Baterr
32	N/ST TEC Vlore _35/6 kV	83	N.ST Suç
33	N/ST Gorisht _35/6 kV	84	N.ST Shutri
34	N/ST Amonice _35/6 kV	85	N.ST Fush-Alie
35	N/ST Kocul _35/6 kV	86	N.ST Peshkopi
36	N/ST Smokthine _35/10 kV	87	N.ST Vojnik
37	N/ST Mifol _35/10 kV	88	N.ST Fush-Arrez
38	N/ST Himare e vjeter _35/10 kV	89	N.ST Pukë
39	N/ST Radhime _35/10 kV	90	N.ST Tuç
40	N/ST Orikum _35/10 kV	91	N.ST Gropaj
41	N/ST Kuc _35/10 kV	92	N.ST Rexhepaj
42	N/ST Sarande e vjeter _35/10 kV	93	N.ST Kalimash i Vjeter
43	N/ST Sarande e Re _110/20 kV	94	N.ST Kalimash i Ri

44	N/ST Bunec_35/10 kV	95	N.ST Krume
45	N/ST Gjirokaster e vjeter_110/35/6 kV	96	N.ST B.Curri i Ri
46	N/ST Grapsh_35/10 kV		
47	N/ST Tepelene_110/10 kV		
48	N/ST Krahes_110/10 kV		
49	N/ST Kelcyre_110/10 kV		

Numri i inxhinierëve, specialistëve dhe punonjësve sipas profesioneve perkatese, eshte kerkuar duke pare klasifikimin e rendesise se vecante qe kane N.Stacionet elektrike te Shperndarjes.

Numri i tyre ne punimet e rikonstruksionit, civile, elektrike ne ndertesat e N.Stacioneve eshte bazuar ne zerat dhe volumet e parashikuar ne punimet e preventivit, per arsyet e meposhtme:

- Punimet civile duhet te kryhen sa me shpejte, dhe me kujdesin maksimal duke zbatuar rregullat e sigurimit teknik sepse jane punime brenda N.Stacioneve elektrike, dhe nen rrezikun e jetes.
 - Duke patur numrin e madh te N.Stacioneve qe mendohet te rikonstruktohen, duhet te kryhen punime njekohesisht ne disa N.Stacione, te cilet do te percaktohen ne varesi te punimeve, por edhe te shtrirjes gjeografike te tyre, duke qene ne distanca te largeta nga njeri tjetri.
 - Numri i mjaftueshem por i nevojshem i punonjësve te mesiperm, eshte menduar edhe per arsye sigurie, duke qene punime brenda N.Stacioneve, ne menyre qe punonjesit te mos jene te tejlodhur nga puna, duke qene edhe pune e veshtire fizikisht.
- **Inxhinieri i Ndërtimit** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve objekt kontrate për të gjithë zërat e punimeve ndërtimore, sipas parashikimeve në projektet përkatëse që do të hartohen rast pas rasti.
 - **Inxhinieri Hidroteknik** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve hidroteknike lidhur me zërat e punimeve të parashikuara projektet përkatëse që do të hartohen rast pas rasti.
 - **Inxhinieri Elektrik** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve elektrike lidhur me zërat e punimeve të parashikuara në projektet përkatëse që do të hartohen rast pas rasti..
 - **Arkitekti** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve sipas parashikimeve në projektet përkatëse që do të hartohen rast pas rasti. Duke ruajtur si fasaden arkitekturore te ndertesave

te N.Stacioneve disa prej te cileve si N.Stacioni Shkozet, Selite kane fasade te vecante, te ndertuar rreth 70 vjet perpara, prandaj duhet ruajtur si ne forme ashtu edhe ne ngjyrat e saj.

- **Tekniku i ndërtimit** është i nevojshem për ndjekjen e realizimit të punimeve të ndërtimit, sipas zërave të preventivit të punimeve.
 - **Teknik hidraulik** është i nevojshem për ndjekjen dhe realizimin e punimeve sipas parashikimeve në projektet përkatëse që do të hartohen rast pas rasti.
 - **Teknik Elektrik** është i nevojshem për ndjekjen dhe realizimin e punimeve elektrike sipas parashikimeve në projektet përkatëse që do të hartohen rast pas rasti.
 - **Hidrauliku** është i nevojshem për ndjekjen dhe realizimin e punimeve hidraulike, sipas zërave të preventivit të punimeve.
 - **Elektriçisti** është i nevojshem për ndjekjen dhe realizimin e punimeve elektrike, sipas zërave të preventivit të punimeve.
 - **Përgatitës të konstruksioneve metalike dhe të ngjashëm** është i nevojshëm për përpunimin, prerjen, bashkimin dhe montimin e elementëve metalik, në konstruksione prej metali, sipas zërave të preventivit të punimeve.
 - **Saldator dhe prerës të metaleve** janë të nevojshëm për saldimin, drejtimin, bashkimin e detaleve të ndryshëm, me prerjen e tyre, me bashkimin e objekteve të madhësive dhe formave të ndryshme duke përdorur mjetet dhe pajisjet e duhura, sipas zërave të preventivit të punimeve.
 - **Hidroizoluesi** është i nevojshëm për realizimin e punime të termo-izolimit me materialin e duhur sipas zërave të preventivit të punimeve.
 - **Muratori** është i nevojshëm për realizimin e punimeve të lyerjes, sipas zërave të preventivit
 - **Bojaxhiu** është i nevojshëm për realizimin e punimeve të lyerjes, sipas zërave të preventivit.
 - **Shtrues pllakash dhe të tjerë që lidhen me to** është i nevojshëm për realizimin e punimeve të shtrimit të pllakave dhe bordurave të betonit, sipas zërave të preventivit të punimeve.
- g) Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se kanë të punësuar në stafin e tyre 1 (një) punonjës i cili të plotësojë kërkesat dhe të disponojë çertifikatën si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë”, në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10237 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier".

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin :

- kontratën e punës,
- diplomën/certifikatën përkatëse.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraparak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi (2.3.3 c)

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe në nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht :

Kërkesa e mësipërme mbështetet në ligjin nr. 10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”. Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr. 312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ofrojë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënës zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.

h) Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të dëshmojnë se kanë të punësuar në stafin e shoqërisë punonjës të kualifikuar, të pajisur me Dëshmi të Aftësive Profesionale (DAP), lëshuar nga D.P.SH.T.RR., minimalisht si më poshtë :

- Automakinist 2 (dy)

(Në rastet kur mjetet/makineritë dispononohen me qera, këta punonjës mund të jenë të kontraktuar).

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin :

- Kontratat e punës të vlefshme;
- Dokument (dëshmi kualifikimi profesional), që të vërtetojë kualifikimin profesional të kërkuar, referuar rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtim dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre”, miratuar me urdhërin nr. 200, datë 16.5.2019, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjitikës.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi (2.3.3. d)

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe në nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës, si dhe bazuar në rregulloren “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtim dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre”, miratuar me urdhërin nr. 200, datë 16.5.2019, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjitikës.

Automakinistët kërkohen në fuksion të përdorimit të mjeteve si autobetoniere, autopomë betoni dhe autovinç.

- i) Të gjithë punonjësit e kërkuar sipas pikës 2.3.3, duhet të jenë në listpagesat e shoqërisë, për periudhën Gusht - Tetor 2025. Përfshirë nga kjo bëjnë punonjësit e kualifikuar si (Automakinist), të kërkuar sipas gjurmës “d”, të cilët përveç se si pjesë të stafit të ofertuesit (në listpagesat e tij) mund të jenë të kontraktuar vetëm në rastet kur mjetet/makineritë disponohen me qera.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, duhet të dorëzojë pranë autoritetit kontraktor përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK, dokumentacionin si më poshtë :

- Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën Gusht - Tetor 2025.

Argumentimi (2.3.3. e)

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe në nenin 39, pika 6/ç), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore si pjesë të përvojës së shoqërisë, përvojë kjo e nevojshme për ekzekutimin e kontratës objekt prokurimit, pasi fakti që shoqëria disponon personel të kualifikuar në vijimësi, tregon aftësi të larta profesionale dhe mundësi të mira për organizimin e punës dhe zbatimin me sukses të kontratave që do të lidhen gjatë zbatimit të MK.

Kriteri sipas pikës 2.3.3. “e”, të kapacitetit teknik, ku kërkohet që punonjësit të jenë pjesë e shoqërisë për një periudhë tre mujore, vlerësohet në përputhje me natyrën e objektit të prokurimit dhe në funksin të përzgjedhjes së OE që zotërojnë aftësinë teknike dhe profesionale për zbatimin e kontratës.

2.3.4 Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës :

Nr .	Mjete/pajisje teknike	Sasia	Gjendja
1	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës jo më pak se 10 ton	1 copë	Në pronësi ose me qera
2	Kamionçinë me kapacitet mbajtës deri në 3.5 ton	1 copë	Në pronësi ose me qera
3	Autobetoniere	1 copë	Në pronësi ose me qera
4	Autopompë betoni	1 copë	Në pronësi ose me qera
5	Autovinç	1 copë	Në pronësi ose me qera
6	Elektrosaldatriçe	2 copë	Në pronësi ose me qera
7	Moto gjenerator	1 copë	Në pronësi ose me qera
8	Matrapik	2 copë	Në pronësi ose me qera
9	Depozite uji (kapaciteti minimal 2000 litra)	2 copë	Në pronësi ose me qera
10	Vibrator betoni	2 copë	Në pronësi ose me qera

11	Betoniere kantieri	2 copë	Në pronësi ose me qera
12	Tranxhe për perpunimin e hekurit te ndertimit	2 copë	Në pronësi ose me qera
13	Kontenier ndërtimi stacionar (zyrë)	1 copë	Në pronësi ose me qera

Ofertuesi për makineritë, të cilat janë në pronësi ose me qera, duhet të paraqesë, dokumentacionin e mëposhtëm :

Për mjetet që janë në pronësi, duhet të paraqitet :

- a) dokumenti që vërteton pronësinë (çertifikatën e pronësisë së mjetit rrugor);
- b) dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi);
- c) çertifikata e vlefshme e kontrollit teknik (SGS);
- d) siguracioni (polica e sigurimit) i vlefshëm i mjetit;
- e) leje transporti nga njësia vendore (sipas rastit);
- f) foto të mjetit ku të evidentohen qartësisht të dhënat specifike të tij.

Kur janë me qera, duhet të paraqitet :

- a) kontrata e qerasë;
- b) dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi);
- c) çertifikata e vlefshme e kontrollit teknik (SGS);
- d) siguracioni (polica e sigurimit) i vlefshëm i mjetit;
- e) leje transporti nga njësia vendore (sipas rastit);
- f) foto të mjetit ku të evidentohen qartësisht të dhënat specifike të tij.

Për mjetet apo pajisjet e tjera që nuk pajisen me leje qarkullimi, ofertuesi duhet të paraqesë kontratë noteriale të blerjes ose fatura tatimore të blerjes ose dokument zhdoganimit të mjetit dhe foto të tyre.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi (2.3.4)

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe në nenin 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme

për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Mjetet dhe pajisjet e kërkuara janë vendosur në proporcion me zërat dhe volumet e punimeve dhe afatin e përlllogaritur për realizimin e kontratës objekt prokurimi.

Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve në pronesi / qira janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke i'u referuar punimeve sipas standardeve, kohëzgjatjes së punimeve dhe specifikimeve teknike të projekt zbatimit. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomikë duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin ofertuesit. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisjet dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave.

Mjetet dhe pajisjet si më sipër kërkojnë referuar zërave të preventivit të punimeve.

Konkretisht mjetet dhe pajisjet e kërkuara, janë si më poshtë :

- Kamionat vetëshkarkues me kapacitet mbajtës jo më pak se 10 ton dhe kamionçinat me kapacitet mbajtës deri në 3.5 ton, janë kërkuar në funksion të realizimit të zërave të punës, referuar preventivit të punimeve si (Transport dheu dhe mbeturinash me auto deri në 10km).
- Kamionçinë me kapacitet mbajtës deri në 3.5 ton është kërkuar për nevoja transporti të materialeve të ndryshme.
- Autobetoniere dhe autopompë betoni janë kërkuar në funksion të realizimit të zërave të punës, referuar preventivit të punimeve si Shtresë betoni etj.
- Autovinç është kërkuar në funksion të realizimit të zërave të punës, referuar preventivit të punimeve.
- Elektrosaldatriçe është kërkuar në funksion të realizimit të zërave të punës, referuar preventivit të punimeve si (saldime të ndryshme profilesh metalike, ele dhe llamarine).
- Moto gjenerator është kërkuar në rastet kur në kantier mungon energjia elektrike në kantier.
- Depozite uji (kapaciteti minimal 2000 litra) është kërkuar për përgatitjen e shtresave me çimento, referuar preventivit të punimeve.
- Vibrator betoni është kërkuar në funksion të realizimit të zërave të punës, referuar preventivit të punimeve.
- Matrapik është kërkuar në funksion të realizimit të zërave të punës, referuar preventivit të punimeve.
- Betoniere kantieri është kërkuar në funksion të realizimit të zërave të punës, referuar preventivit të punimeve.

- Tranxhe për perpunimin e hekurit të ndërtimit është kërkuar në funksion të realizimit të zërave të punës, referuar preventivit të punimeve si (F.V. hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm dhe F.V. hekur betoni periodik Ø > 12 mm, etj).
- Kontenier ndërtimi stacionar (zyrë).

2.3.5 Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se e zhvillojnë aktivitetin e tij në fushën objekt prokurimi në përputhje me standardet e menaxhimit të cilësisë, të shëndetit e sigurisë në punë të mjedisit dhe se proceset e saldimit realizohen sipas standardeve më të larta teknike. Për këtë duhet të paraqesin certifikatat e mëposhtme :

- Certifikatë **ISO 9001:2015** ose ekuivalente mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituara për këtë qëllim;
- Certifikatë **ISO 45001 - 2018** ose ekuivalente mbi “Sistemin e Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në punë” lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim;
- Çertifikatë **ISO 14001:2015** ose ekuivalente mbi “Sistemet e menaxhimit të mjedisit”, lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituara për këtë qëllim.
- Certifikatën **ISO 3834-2:2021**, ose ekuivalente mbi “Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë në Saldim”, lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituara për këtë qëllim.

Certifikatat si më sipër duhet të paraqiten origjinale ose kopje të noterizuara, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Certifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.

Argumentimi : Kjo kërkesë është vendosur për të vërtetuar pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, standardet për shëndetin dhe sigurinë në punë dhe standardet e menaxhimit të mjedisit. Ky kriter është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe në nenin 44, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se plotësojnë standartet e kërkuara të cilësisë, të shëndetit e sigurisë në punë dhe të mjedisit.

Për vet natyrën e veçantë, rëndësinë, vendndodhjen dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë, të shëndetit e sigurisë në punë dhe të mjedisit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përsa kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës.

ISO 9001: është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërmarrjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërmarrje duhet t'i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërmarrjes në standartet e tregut. Autoriteti Kontraktor gjykon se çdo ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001: me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

ISO 45001: është standard ndërkombëtar, i cili parashtrohet kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001- me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

ISO 14001: ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. Autoriteti Kontraktor gjykon se çdo ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001: me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

ISO 3834-2:2021: përfshin kërkesa gjithëpërfshirëse të cilësisë për saldimit me shkrirje të materialeve metalike si në punishte ashtu edhe në vendet e instalimit në terren. Autoriteti Kontraktor gjykon se cilësia e punimeve të saldimit është e rëndësishme sepse konstruksionet metalike ku janë të instaluar pajisjet elektrike të N.Stacioneve si celesa fuqie, ndaresa, transformatore rryme dhe tensioni, shkarkues etj, dhe që kërkojnë saldime aty ka keq demtime, kërkojnë cilësi të larta punimi nga saldatori specialist sepse kanë si nagrkese vertikale nga pesha, edhe ngarkese nga vibrimet, pjesë e procesit të punës së pajisjeve elektrike në ngarkese.

Shënim 1 :

Ofertuesit kanë detyrimin që të hartojnë ofertat e tyre në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit, përfshirë këtu edhe preventivin, i cili duhet të përgatitet sipas parashikimeve të :

- **nenit 29 të Rr.P.P., miratuar me VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se oferta ekonomike përmban vlerën ekonomike pa TVSH.**

- dokumenteve të tenderit, Seksioni I - Udhëzime për operatorët ekonomikë, B - Përgatitja e ofertave, pika 6, nën pikat 3 & 4, ku përcaktohet se:

- Të gjitha çmimet duhet të kuotohen në Monedhën sipas Njoftimit të Kontratës, duke përfshirë edhe tatimet dhe taksat që zbatohen, pa përfshirë TVSH-në.

- Ofertuesi duhet të shënojë në Formularin e Ofertës, çmimet totale të Ofertës për të gjithë zërat e preventivit pa TVSH. Vlera e TVSH-së, kur aplikohet, i shtohet çmimit të dhënë dhe përbën vlerën totale të Ofertës.

Mos respektimi këtyre kërkesave do të konsiderohet si devijimi/shmangie e ofertuesit nga kërkesat e specifikuara në dokumentet e tenderit dhe do të sjellë refuzimin e ofertës.

Shënim 2 : Bazuar në parashikimet e Rr.P.P. miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku konkretisht në pikën 6, të nenit 26, parashikohet:

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin...

Përsa më sipër, ofertuesi i kualifikuar, i pari, duhet të dorëzojë pranë autoritetit kontraktor dokumentacionin, e parashikuar në pikën 6, të nenit 26, të Rr.P.P., brenda afatit 5 ditor që ka në dispozicion autoriteti kontraktor, për publikimin e njoftimit të fituesit paraprak, sipas nenit 97/1, të LPP-së.

Shënim 3 : Në respekt të nenit 36 të Ligjit Nr. 162 datë 23/12/2020 “Për prokurimin publik” në të gjithë rastet kur në DT, preventiv, specifikime teknike apo çdo dokument shoqërues është cituar ndonjë markë, përfshihet termi “ose ekuivalent i tij/i saj”, pasi në cdo rast emërtimi është bërë për arsye orientimi dhe nuk ka efekt kufizues apo përjashtues.

Kudo në specifikimet Teknike ku është cituar Standart ndërkombëtar do të pranohet edhe cilësim ekuivalent nga një institut vendor.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Kohezgjatja 24 muaj